



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:211933

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05388303

KPPP.nr.1613/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit D.M.S., nga fshati Koretishtë, Komuna e Novobërdës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.R. avokat nga Gjilani, kundër debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit paraprak të prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.328/23 të datës 12.09.2023, të lejuar nga Përbaruesi Privat Kushtrim Musa me seli në Gjilan, jashtë seancës me datën 16.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet **JO KOMPETENTE NË PIKËPAMJE LËNDORE** për të vendosur sipas prapësimit të debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.328/23 të datës 12.09.2023, të lejuar nga Përbaruesi Privat Kushtrim Musa.
- II. Pas plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore Prishtinë– Departamentit të Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Gjykata, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës KPPP.nr.1613/23 në çështjen përbarimore të kreditorit D.M.S. kundër debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës dhe gjeti se Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas prapësimit lidhur me këtë çështje.

Meqenëse në rastin konkret çështja përbarimore zhvillohet në mes të kreditorit si person fizik dhe debitorit si person juridik, me kërkesë për pagesën e borxhit sipas dokumentit përbarues-Vendimit Përfundimtar nr.09/115 të datës 17.12.2019, të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ndërsa me nenin 13 par.1 nën par. 1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale (Ligji nr. 08/L-15) përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar: *“kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, dhe nën par. 1.2 të po të njëjtit nen, ku përcaktohet se: *“të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*, që rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate për vendosje, pasi që në rastin konkret në cilësinë e kreditorit është personi fizik, ndërsa në cilësinë e debitorit është personi juridik.

Ndërsa duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat dhe nenin 5 par. 5 të

Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore i cili përcakton se *“ Për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankesë, parregullsi në procedurën përbaruese sipas nenit 52 dhe 67 të këtij ligji, ose çfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarra nga Përbaruesi privat, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin apo nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin në të cilin ka vendqëndrimin nëse është person fizik. Nëse debitori është person juridik, kompetencë territoriale ka Gjykata kompetente ku gjendet selia e debitorit..”*, kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke qenë se selia e debitorit është në territorin e Komunës së Prishtinës.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1613/23, me datë 16.02.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.